

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kardinali shqiptar ishte me Mbretin Charles, hajdutët shembin murin dhe i grabisin shtëpinë
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392633.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 08:06:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	19 shtator 2026, 07:52:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 19 shtator 2026, 07:51:00 UTC → 19 shtator 2026, 07:53:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8b5b561962802b5d1e76331d51c1ea35b1fa021145c0c47d1c40d0c9c5791236
TEKSTI	d952bb7b2c85dd539be07146fa070435b3f04dd1ef636cd6dad7f90917c49236
PAMJA	41464c832e29bb5c8233031b0e29863f74f677e10d191dae910235bc6e98b7d7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	195f57eef58e1e47add904c8e614c819c9b5c27ea68b5f6d3071d599affa28a2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2efc04bea43acf0f6a2e38be2863702e338fd789cd0cf3c1cc14a88f36ac9872
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/195f57eef58e1e47add904c8e614c819c9b5c27ea68b5f6d3071d599affa28a2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kardinali shqiptar ishte me Mbretin Charles, hajdutët shembnin murin dhe i grabisin shtëpinë

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 19.09.2026, 09:52



Share



Share



Një grabitje e pazakontë është regjistruar në banesën e kardinalit shqiptar Ernest Simoni, në zemër të Firences, ndërsa 97-vjeçari ndodhej në Londër, ku kishte zhvilluar një takim me Mbretin Charles III.

Autorët kanë përdorur një mënyrë të pazakontë për të hyrë në apartamentin që ndodhet në Piazza Duomo: kanë dëmtuar murin pranë derës dhe më pas kanë arritur të hapin me forcë derën e blinduar. Pas kontrollit të plotë të banesës, grabitësit janë larguar me para dhe sende me vlerë, të cilat sipas raportimeve arrijnë në rreth 30 mijë euro.

Sipas Corriere Fiorentino, apartamenti ndodhet në një banesë në pronësi të Kurisë dhe kardinali jeton aty së bashku me nipin e tij, Tonin Simoni, restaurator që ushtron aktivitetin në Firence.

Në momentin kur ndodhi grabitja, banesa ishte bosh. Kardinali ndodhej në Londër, ndërsa Tonin Simoni dhe bashkëshortja e tij kishin dalë rreth orës 13:00. Kur u kthyen, rreth orës 23:00, gjetën apartamentin të përmbysur.

Muri pranë hyrjes ishte dëmtuar rëndë, ndërsa dera e blinduar ishte çarë dhe hapur me forcë. Hajdutët kishin kontrolluar praktikisht çdo ambient të shtëpisë, duke hapur garderobat, valixhet, sirtarët dhe kasetat në kërkim të sendeve me vlerë. Dy dalat që dyshohet se janë përdorur për të hyrë në banesë u gjetën të braktisura në korridorin e pallatit.

Një nga elementët që ka tërhequr vëmendjen e hetuesve është mënyra dhe koha e realizimit të grabitjes. Dëmtimi i murit dhe hapja e derës së blinduar do të kërkonin punë dhe, mbi të gjitha, do të shkaktonin zhurmë. Megjithatë, deri tani nuk raportohet që ndonjë prej banorëve të pallatit të ketë vënë re diçka të dyshimtë. As prifti që jeton në katin poshtë nuk ka dëgjuar zhurma.

"Nuk e prisim kurrë një gjë të tillë. Mendonim se ishim të sigurt. Është e pabesueshme që një grabitje e tillë të ndodhë në Piazza Duomo, ndoshta edhe në mes të ditës. Është një turp për qytetin", ka deklaruar Tonin Simoni.

Ai dyshon se grabitësit e kishin studiuar më parë banesën dhe lëvizjet e familjarëve.

"Jam i bindur se na kishin vëzhguar. E dinin saktësisht që nuk ndodhej askush në shtëpi", tha ai.

Mes sendeve të marra nga banesa ishin para cash, sende floriri, bizhuteri të bashkëshortes së Toninit, medalje dhe një vulë prej ari. Grabitësit morën gjithashtu edhe lejen e qëndrimit të kardinalit Ernest Simoni, e cila mbahej në një prej sirtarëve.

"Vjedhja e këtij dokumenti është e çuditshme. Nuk e kuptoj pse mund t'i duhej dikujt, përveç rastit kur synon ta falsifikojë", u shpreh nipi i kardinalit.

Në vendngjarje mbërritën karabinierët, ndërsa specialistët e policisë shkencore kryen ekzaminimet për mbledhjen e gjurmëve të mundshme të autorëve. Hetuesit po shqyrtojnë gjithashtu namiet e kamerave të sigurisë në zonën e



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Piazza Duomo, e cila konsiderohet ndër pjesët më të monitoruara të Firences.

“Piazza Duomo është zona më e mbikëqyrur e qytetit. Është e pabesueshme që dikush arriti të bënte një gjë të tillë pikërisht këtu”, tha Tonin Simoni.

Pas zbulimit të grabitjes, ai kontaktoi menjëherë në telefon kardinalin, i cili ndodhej në Londër. Por ajo që e shqetësoi më shumë Ernest Simonin nuk ishin paratë apo sendet me vlerë që mungonin.

Sipas nipit të tij, pyetja e parë e kardinalit ishte nëse hajdutët kishin prekur objektet fetare që ai mban në dhomën e tij, e cila i ngjan një kapelë të vogël.

“Ai më pyeti për statujën e Zojës së Medjugorjes dhe për atë të Atë Pjos. Kur i thashë se ishin të gjitha në vend, ai më tha: ‘Atëherë, pak rëndësi ka’”, tregoi Tonin Simoni.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.